



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM
Nr. 17, Datë 26.01.2022

MBI
NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 179, DATË 08.11.2017,
“MBI ÇERTIFIKIMIN E SHOQËRISË “OPERATORI I KOMBINUAR I GAZIT
NATYROR” ALBGAZ SH.A.” , I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; neneve 37 dhe 80, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 26.01.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 128 prot., datë 21.01.2022 e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes dhe Drejtoria e Gazit Natyror, “Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 179, datë 08.11.2017, “Mbi çertifikimin e shoqërisë “Operatori i Kombinuar i gazit natyror” Albgaz sh.a.”, i ndryshuar”,

Konstatohet se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 152, datë 30.06.2021, vendosi:
 1. Të ndryshojë pikën 5.1 dhe pikën 5.2, të vendimit të bordit të ERE-s nr. 179, datë 08.11.2017, si më poshtë:

5.1. Shoqëria “ALBGAZ” sh.a. të paraqesë në ERE çdo vit ushtrimor informacion mbi pavarësinë e audituesve financiarë.

5.2 Shoqëria “ALBGAZ” sh.a. të marrë masa për të paraqitur në ERE brenda datës 20.01.2022 provat dokumentare për bashkëpunimin ndër-institucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor, neni 11 dhe neni 46, pika 10, të ligjit “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar dhe transferimin e kompetencave tek Ministria e Ekonomisë dhe e Financave.

Kjo shtyrje u vendos për shkak të pamundësisë së “Albgaz” sh.a. për ti plotësuar këto kushte në afat.

- Sa i përket kushtit që lidhet me paraqitjen në ERE çdo vit ushtrimor të informacionit mbi pavarësinë e audituesve financiarë shoqëria “Albgaz” sh.a. ka paraqitur dokumentacionin respektiv dhe si i tillë ky kusht konsiderohet i plotësuar/përditësuar për vitin 2020 dhe pika 5.1 e vendimit nr. 179/2017 mbetet e pandryshuar.
- Për kushtin që lidhet me bashkëpunimin ndër-institucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor, Neni 11 dhe 46 (10), i Ligjit për Sektorin e Gazit Natyror dhe transferimin e kompetencave tek Ministria e Ekonomisë, shoqëria “Albgaz” sh.a. bën me dije se ka qenë në komunikim të vazhdueshëm shkresor dhe verbal me MIE-n me qëllim përmbushjen e këtij kushti. Po ashtu “Albgaz” sh.a. informon se është pranë arritjes së një zgjidhjeje të gjithëpranuar nga palët, dhe për këtë arsye kërkon nga ERE shtyrjen e afatit të përcaktuar në vendimin nr. 152/2021, **deri në datën 20.11.2022.**
- Në lidhje me shtyrjen e afateve procedurale nga organi publik, ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, neni 53, pika 3, citon se: “*Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.*”
- Kërkesa e shoqërisë “Albgaz” sh.a. për shtyrje të afatit të depozitimit të dokumentacionit që lidhet me pikën 5.2, të vendimit nr. 179/2017 është protokolluar në zbatim të legjislacionit në fuqi, përpara përfundimit të afatit të vendosur në vendimin e bordit të ERE-s nr. 152, datë 30.06.2021.
- Për qëllime të kësaj kërkesë shoqëria ka dhënë sqarime për shtyrjen e afatit të plotësimit të kushteve deri në datën 20.11.2022.
- Në vijim shoqëria duhet të dokumentojë në ERE çdo tre muaj informacion për përpjekjet konkrete të bëra në lidhje me realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të ndryshojë pikën 5.2, të vendimit të bordit të ERE-s nr. 179, datë 08.11.2017, të ndryshuar, si më poshtë:
5.2 Shoqëria “ALBGAZ” sh.a. të marrë masa për të paraqitur në ERE **brenda datës 20.11.2022** provat dokumentare për bashkëpunimin ndër-institucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor, neni 11 dhe neni 46, pika 10, të ligjit “Për Sektorin e Gazit

Natyror”, i ndryshuar dhe transferimin e kompetencave tek Ministria e Ekonomisë dhe e Financave.

2. Shoqëria “Albgaz” sh.a. duhet të dërgojë në ERE çdo tre muaj nga miratimi i këtij vendimi, informacion për përpjekjet konkrete të bëra në lidhje me realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor.
3. Ky vendim i shtrin efektet duke filluar nga data 20.01.2022.
4. Drejtoria e Gazit Natyror, të njoftojë aplikuesin dhe MIE-n për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI